

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6450
E enjte, 28 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Apeli refuzon kërkesën e Thaçit, mbetet në paraburgim



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ATDHE HYKOLLI

QEVERIA ME URGJENCË TË VENDOSË PËR RRIJTJEN E PAGËS MINIMALE



Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, ka thënë se gjendja e punëtorëve, sidomos e atyre në sektorin privat në Kosovë, nuk është e mirë. Në këtë kontekst, ai ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që me urgjencë të vendosë për rritjen e pagës minimale. "Kërkojmë që paga minimale të rritet sa ma parë që të jetë e mundshme në mënyrë që ta reflektojë rritjen e kostos së jetesës dhe rritjen e çmimeve", ka thënë ai në këtë intervistë për "Epokën e re". Po ashtu, Hykolli ka kërkuar miratimin e Ligjit për Pagat dhe të atij për Sigurimet Shëndetësore

PAS RRIJTJES SË ÇMIMEVE, QEVERIA MBËSHTËT SKEMAT SOCIALE DHE PENSIONALE

Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete për t'i mbështetur financiarisht skemat sociale dhe pensionale. Në mbledhjen e të mërkurës, kabineti qeveritar ka marrë vendim t'ua ndajë nga 100 euro shtesë të gjithë pensionistëve për muajin nëntor, kurse për muajin nëntor dhe dhjetor ka dyfishuar pagesat për skemat sociale. Shoqëria civile ka reaguar ndaj këtyre vendimeve, duke thënë se ndarja e mjeteve financiare për kategori të caktuara në kohë fushate është abuzim me resurset shtetërore për përfitime të partisë në pushtet



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepgjsh - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



NDËRRON JETË REGJISORJA
BURBUQE BERISHA F. 6

VALDETE DAKA NIS BETEJËN
LIGJORE KUNDËR VENDIMIT TË
PRESIDENTES OSMANI F. 7

KUSHTETUESJA PEZULLON
VENDIMIN E KUVENDIT PËR
SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË
KPMSHCK-së F. 7

FILLON SHPËRNDARJA
E 140 MIJË VAKSINAVE
KUNDËR GRIPIT SEZONAL F. 6

IKD-ja: TË NDALEN DEKLARATAT
POLITIKE QË CENOJNË PAVARËSINË
E SISTEMIT GJYQËSOR F. 4-5

EKONOMI

MIRATOHET PROJEKTRREGULLORJA
QË TATIMI NË PRONË TË MOS
JETË KUSHT PËR REGJISTRIMIN
E AUTOMJETEVE F. 8

FORMOHET KOMISIONI
QEVERITAR PËR RRUGËN
PRIZREN - TETOVË F. 8

SPORT



SHABANI: GJILANI
DO TË RIKTHEHET
DUARBOSH NGA KLINA F.10

Izetbegoviqi përmend luftën: Nëse njerëzit duan të jetojnë, duhet të jenë gati të vdesin

SARAJEVË, 27 TETOR - Kryetari i Partisë së Veprimit Demokratik (SDA) në Bosnjë e Hercegovinë, Bakir Izetbegoviqi, ka folur sërish për mundësinë e luftës. Izetbegoviqi, ndonëse ka thënë se është i mendimit se s'do të

ketë luftë, ka shtuar se është gati nëse do të ketë. "Nëse njerëzit duan të jetojnë, ata duhet të jenë gati të vdesin. Nëse duan paqe, duhet të jenë gati për luftë", ka thënë Izetbegoviqi. Edhe më herët Izetbegoviqi e ka

lënë të hapur mundësinë e një lufte të re në Ballkan, kur kishin dalë "non-papers" nga Sllovenia në të cilat flitej për ridefinim të kufijve në Ballkan, që përfshinte ndarjen e Bosnjës.



BE-ja po shqyrton rihapjen e misionit në Afganistan



BRUKSEL, 27 TETOR - Bashkimi Evropian (BE) nuk e ka në plan ta njohë zyrtarisht qeverinë e udhëhequr nga talebanët, megjithatë është duke e shqyrtuar mundësinë e rihapjes së misionit diplomatik në Afganistan, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Nabila Massrali, zëdhënëse e shefit të politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell. "Ajo për të cilën po angazhohet BE-ja tani është krijimi i një pranie minimale në terren", ka thënë ajo.

Më 24 tetor "Financial Times" ka raportuar se Bashkimi Evropian po synon ta rihapë përfaqësinë diplomatike në Afganistan. Sipas

kësaj media, kjo po planifikohet të ndodhë brenda një muaji në kuadër të përpjekjeve ndërkombëtare për t'u përballur me administratën e talebanëve. Mirëpo, zëdhënësjë e BE-së nuk ka përmendur afate kohore. Ajo ka thënë se një rivendosje e pranisë në Afganistan nuk përbën njohje zyrtare për administratën e talebanëve.

Talebanët kanë marrë kontrollin e Afganistanit në fund të muajit gusht pas tërheqjes së forcave ushtarake të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara.

BE-ja, sipas zëdhënëses Massrali, synon që përmes një pranie në këtë vend të mundësojë ndihmën

për afganët në nevojë dhe, gjithashtu, t'u ofrojë ndihmë shtetasve të BE-së të cilët duan të largohen nga vendi.

Komisioni Evropian më 12 tetor ka premtuar ndihmë prej një miliard eurosh për Afganistanin. Ndihma e komunitetit ndërkombëtar është e kushtëzuar për talebanët pasi atyre u kërkohet, ndër të tjera, të mos lejojnë që territori të përdoret nga grupe terroriste, respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe lejin e forcave të tjera politike në një qeveri kalimtare. Massrali ka thënë se për ta rifilluar ndihmën e rregullt këto kushte duhet të plotësohen.

ShBA-ja ia anulon licencën një kompanie kineze për komunikime

UASHINGTON, 27 TETOR - Uashingtoni ia ka anuluar licencën amerikane një prej kompanive më të mëdha kineze për telekomunikime, duke cituar shqetësimet për "siguri kombëtare".

Kompania "China Telecom" duhet ta ndalojë ofrimin e shërbimeve në Shtetet e Bashkuara brenda 60 ditëve. Zyrtarët kanë thënë se kontrolli i qeverisë kineze në këtë kompani i ka dhënë asaj mundësi "të ketë qasje, të ruajë, t'i pengojë dhe t'i çojë në drejtim të gabuar komunikimet amerikane". Kjo gjë mund t'i mundësojë asaj "të përfshihet në spiunim dhe aktivitete të

tjera të dëmshme kundër ShBA-së", kanë thënë zyrtarët.

"China Telecom", e cila ka ofruar shërbime të telekomunikimeve në ShBA për gati 20 vjet, e ka quajtur vendimin "zhgënjyes".

"Ne planifikojmë të ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme teksa vazhdojmë t'u shërbejmë konsumatorëve tanë", ka thënë kompania përmes një deklarate. "China Telecom" është një prej tri kompanive që dominojnë tregun e telekomunikimeve në Kinë.

Kompania ka qindra miliona konsumatorë në 110 shtete dhe shërbimet dallojnë nga interneti e deri te rrjetet telefonike.



Vdes i mbijetuari i Hiroshimës dhe luftëtari japonez kundër armëve bërthamore

TOKIO, 27 TETOR - Luftëtari kryesor kundër armëve bërthamore në Japoni, i cili i kishte mbijetuar sulmit të parë me bombë atomike në botë, ka vdekur në moshën 96-vjeçare. Sunao Tsuboi ishte rugës për fakultet kur u godit nga shpërthimi në Hiroshimë më 6 gusht 1945, nga i cili pësoi djegie në të gjithë trupin.

Rreth 140 000 njerëz ishin vrarë në atë sulm, kurse Tsuboi ia kushtoi jetën e tij fushatës për t'i luftuar armët bërthamore. Gjatë jetës së tij, Tsuboi është takuar edhe me Barack Obamën gjatë vizitës së tij historike në Hiroshimë si president i ShBA-së. Më pas ata shtrënguan duart dhe biseduan gjatë takimit të vitit

2016.

Kjo ishte vizita e parë e një presidenti amerikan në këtë qytet që nga sulmi me bombë atomike, që ndodhi afër fundit të Luftës së Dytë Botërore, ndërsa aleatët po shtynin Japoninë. Tsuboi ka vdekur nga anemia më 23 tetor, ka thënë një zyrtar japonez për "AFP"-në.



Gazetari Berisha në Speciale: Si 6-vjeçar ika nga lufta, kalova mbi trupa të vdekur, pa bukë e pa ujë

HAGË, 27 TETOR (ER) - Gazetari Halil Berisha ka dhënë dëshminë e tij në Gjykatën Speciale në rastin e drejtuesve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Gjatë dëshmisë së tij, Berisha ka ndarë edhe një fragment që e kujton nga lufta e që asokohe ai ishte vetëm gjashtë vjeç. Berisha në Gjykatën Speciale ka treguar se si forcat serbe e kishin larguar me forcë atë dhe familjen e tij nga shtëpia dhe se ishin detyruar që të kërkonin strehim në Shqipëri.

Ai ka treguar se si ka kaluar mbi trupa të vdekur, pa bukë e pa ujë. "Unë ndoshta jam i ri në moshë, por edhe unë e kam përjetuar luftën. Kam qenë gjashtëvjeçar në kohën e luftës kur gjatë asaj kohe unë bashkë me familjen time dhe me qytetarët e tjerë jemi larguar me forcë nga banesa nga shtëpia jonë. Jemi larguar me forcë dhe jemi detyruar që të largohemi për në Shqipëri. Kjo çfarë po them unë është më e lehta se çfarë mund të thonë të tjerët. Unë si gjashtëvjeçar jam detyruar të ec drejt kufirit pa bukë, pa ujë dhe forcat serbe kanë vendosur edhe trupa të vdekur në rrugë dhe si një fëmijë gjashtëvjeçar është dashur që të kaloja mbi ta. Është një temë e ndjeshme për ne. Është një temë që shtjellohet çdo ditë te ne dhe

për këtë arsye kemi menduar që kjo ka interes për publikun për të raportuar për këtë çështje", ka thënë Berisha.

Më tutje gazetari Berisha nga prokurori i Speciales është pyetur lidhur me disa shkrime të publikuara në mediumin ku ai punonte. Pas përfundimit të pyetjeve nga prokurori, gazetari Berisha është pyetur edhe nga avokati i Nasim Haradinajt nëse ka qenë ndonjëherë më parë i intervistuar nga Gjykata Speciale.

"Kam qenë i intervistuar në Kosovë", ka thënë ai.

Avokati ka pyetur Berishën edhe për kohën se kur është intervistuar. Ai e ka pyetur gazetarin Berisha nëse intervistimi është bërë më 25 gusht të këtij viti. "Po, sa më kujtohet", ka thënë ai.

Avokati i Haradinajt e ka pyetur Berishën se në çfarë cilësie është intervistuar. "Po, i kam pyetur dhe më kanë thënë që nuk jam në cilësinë e të dyshuarit. Unë jam gazetar dhe nuk e kam pritur që do të më ftojë për intervistim si dëshmitar dhe as si i dyshuar sepse unë e kam kryer punën time në përpikëri dhe profesionale. S'e kam pritur së pari që do të jem i ftuar. Kur më është bërë ftesa unë kam kërkuar që bashkë me mua të jetë edhe avokati Arianit Koci", ka thënë Berisha.



Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt u vazhdohet paraburgimi

Trupi gjykues, i kryesuar nga gjykatësi Charles L Smith II, ua ka vazhduar paraburgimin Hysni Gucatit e Nasim Haradinajt deri në marrjen e vendimit pas pranimit të informatave që kanë kërkuar nga Policia e Kosovës (PK). Dhomat e Specializuara kanë kërkuar nga Policia e Kosovës që deri më 26 nëntor të ofrojë informata për këtë gjykatë.

Këto informata janë kërkuar nga policia lidhur me autoritetin dhe aftësinë (në veçanti për sa i përket personelit dhe burimeve në dispozicion) për t'i kufizuar lëvizjet e individëve që i nënshtrohen lirit të përkohshëm, për t'i monitoruar dhe kufizuar komunikimet e individëve të tillë, për ta administruar arrestin shtëpiak dhe për ta siguruar

ekuivalentin e masave të lartpërmendura gjatë shtrimit në spital. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë duke u akuzuar nga Specialja për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Kurti: Bosht i bisedimeve me Serbinë duhet të jetë njohja reciproke

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, kanë pritur të mërkurën në takim sekretaren e përgjithshme të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Helga Maria Schmid. Në këtë takim është diskutuar edhe për bisedimet me Serbinë. Kurti ka thënë se bosht i tyre duhet të jetë njohja reciproke, dhe se të pagjeturit do të mbeten prioriteti i parë.

Ndërsa zëvendëskryeministri Bislimi, duke folur për dialogun dhe rezultatet që priten nga ai, ka thënë se janë të përkushtuar për arritjen e njohjes reciproke dhe i cilësoi të papranueshme



provokimet që i bën Serbia. "Kurti e njoftoi sekretaren Schmid me punët dhe progresin e qeverisë në këta 7 muaj

qeverisje, për rritjen ekonomike dhe reformat e filluara në drejtësi, në veçanti theksoi përkushtimin për zhvillimin e

arsimit dual si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. U diskutua për bashkëpunimin rajonal dhe kryeministri ritheksoi përkushtimin e Kosovës për bashkëpunim dhe integrim, porse ritheksoi se nuk përkrah nisma rajonale ku nuk është e pranishme pjesëmarrja e BE-së", ka njoftuar zyra e kryeministrit. Sipas këtij njoftimi, sekretarja kryeministrin Kurti për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe për përgatitjen e infrastrukturës ligjore, si fazë e parë për procesin e vetingut si dhe për përparimin në shumë fusha. Ajo e ka vlerësuar veçanërisht angazhimin dhe përkushtimin e qeverisë në luftën

kundër krimit të organizuar, kontrabandës dhe korrupsionit. Sekretarja Schmid ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e mbështetjes dhe ekspertizës për qeverinë në përputhje me nevojat e institucioneve dhe fushëveprimin e OSBE-së. Kurse kryeministri Kurti e ka falënderuar sekretaren Schmid për vizitën dhe ka kërkuar që të ngrehet përfaqësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në OSBE. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Michael Davenport, zëvendësambasadori Kilian Wahl, zyrtarja e Qendrës për Parandalimin e Konfliktit, Mariana Roibu, dhe zyrtarja ekzekutive e sekretares së përgjithshme, Juliane Ziegler.

Apeli refuzon kërkesën e Thaçi, mbetet në paraburgim

HAGË, 27 TETOR (ER) - Paneli i Gjykatës së Apelit, në kuadër të Gjykatës Speciale, ka hedhur poshtë kërkesën e parashtruar nga Hashim Thaçi kundër

vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake për mbajtjen e tij në paraburgim. Sipas Apelit, Thaçi ka dështuar të dëshmojë se

pse vendimi paraprak ka qenë i paarsyeshëm për rreziqet nëse ai lirohet. Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, akuzohet kinse për krime lufte. Pos

tij, për akuza të njëjta ngarkohen edhe Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Kadri Veseli si ish-drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.





QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS

Pas rritjes së çmimeve, qeveria mbështet skemat sociale dhe pensionale

Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete për t'i mbështetur financiarisht skemat sociale dhe pensionale. Në mbledhjen e të mërkurës, kabineti qeveritar ka marrë vendim t'ua ndajë nga 100 euro shtesë të gjithë pensionistëve për muajin nëntor, kurse për muajt nëntor dhe dhjetor ka dyfishuar pagesat për skemat sociale. Shoqëria civile ka reaguar ndaj këtyre vendimeve, duke thënë se ndarja e mjeteve financiare për kategori të caktuar në kohë fushate është abuzim me resurset shtetërore për përfitime të partisë në pushtet

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 TETOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetjen e përfituesve nga skemat sociale dhe pensionale. Me propozimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është aprovuar vendimi, sipas të cilit, do të përfitojnë pagesa shtesë në vlerë të mbështetjes financiare prej 100 eurosh të gjithë përfituesit e skemave pensionale për muajin nëntor. Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për dyfishimin e pagesës mbi vlerën bazë dhe të shtesave të aprovuara për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për periudhën nëntor-dhjetor 2021. Pas mbledhjes, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se shtesat për pensionistët janë bërë për ta përballuar rritjen e çmimeve. "Me vendimin për mbështetjen e skemave pensionale kemi vendosur si qeveri që në kuadër

të mbështetjes dhe pakos së masave që ka paralajmëruar kryeministri të mbështetet secili person që merr pension nga shteti për ta përballuar koston shtesë e cila ka qenë rrjedhë e ditëve dhe muajve të fundit", ka deklaruar ai në një konferencë për media. Ai ka treguar se nga 100 euro do t'i marrin rreth 50 mijë familje që janë familje të veteranëve të luftës dhe familje të dëshmorëve. "Kjo masë është një nga masat me vëllimin më të madh të përmirësimit të jetës së qytetarëve, të mbështetjes së qytetarëve për shkak se prek përafërsisht rreth 300 mijë familje. Në kuadër të kësaj mase do të përfitojnë rreth 200 mijë pensionistë që janë pensionistë të pensione bazike dhe kontributpaguese, do të jenë rreth 50 mijë familje që janë qoftë familje të veteranëve të luftës, familje të dëshmorëve të luftës apo të invalidëve të luftës, do të përfitojnë rreth 20 mijë familje që kanë persona me aftësi të kufizuar dhe do të përfitojnë rreth 30 mijë familje që janë të kategorive të tjera", ka treguar Murati.

Kurti paralajmëron pako ndihmëse për qytetarët

Në hapje të mbledhjes, kryeministri Albin Kurti ka folur për ngritjen e çmimeve të produkteve esenciale si pasojë e pandemisë Covid-19. Para kabinetit qeveritar, ai ka thënë se pasojat e pandemisë Covid-19 në ekonominë globale po e afektojnë edhe Kosovën. "Rritja e çmimit të energjisë elektrike, që është burim i energjisë së produkteve industriale, nxitë edhe ngritjen e çmimit të vajit, sheqerit, drithërave, mishit dhe produkteve të qumështit. Si një vend importues, Kosova nuk kishte si të përbente përjashtim. Përkundrazi, ne varem nga importet e përditshme, e bashkë me importet, rrjedhimisht importojmë edhe inflacionin. Konsumi në Kosovë zë një komponentë të rëndësishme të importit. Ushqimi dhe pijet kryesisht për konsum të ekonomive familjare, përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të importeve totale të mallrave të konsumit",

ka thënë Kurti

Ai ka treguar se qeveria ka nisur të punojë për një pako masash që do t'i ndihmojnë qytetarët të tejkalojnë më lehtë vështirësitë financiare të krijuara nga situata me pandeminë. "Në këtë drejtim, në përputhje me programin tonë qeverisës dhe vizionin tonë për ekonominë, po angazhohemi për nxitje të investimeve në kapacitete të reja prodhuese e eksportuese. Fushata, që në qendër ka fajësimin e qeverisë për këtë rritje të imponuar të çmimeve, për efekt mund të ketë

veçse shtrimin e terrenit për manipuluesit për t'i ngritur çmimet, me pretekstin se tani jemi në një ambient ku secili çmim duhet të ngrehet, pavarësisht se a ka ngritje të koston apo jo, duke përkeqësuar kësaj situatën ndërsa, në anën tjetër, të nxitë nervozë, frikë e panik te qytetarët si konsumatorë", ka thënë kryeministri.

Kryeministri ka përmbyllur fjalën e tij duke u bërë apel qytetarëve që ta ruajnë qetësinë dhe durimin.

Krasniqi: Mbështetja financiare për pensionistët dhe skemat sociale në kohë fushate, abuzim me pushtetin

Analisti Albert Krasniqi ka bërë me dije se vendimi i qeverisë në kohë fushate për dyfishimin e pagesave për skemat sociale dhe shtesat për pensionistët është rast tipik i abuzimit me resurset shtetërore për përfitime të partisë në pushtet. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se në këtë mënyrë dëmtohet procesi zgjedhor përmes krijimit të pabarazisë zgjedhore me partitë e tjera në opozitë. "Vendimi i qeverisë - në kohë të fushatës zgjedhore - për dyfishimin e pagesës për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për dy muaj;

dhe për ndarjen nga 100 euro shtesë për pensionistët për një muaj; është rast tipik i abuzimit me resurset shtetërore për përfitime të partisë në pushtet. Kësaj, dëmtohet procesi zgjedhor përmes krijimit të pabarazisë zgjedhore me partitë tjera në opozitë. Aq më keq, kur për formë të tillë të abuzimit keni kritikuar qeveritë e kaluara - keni kërkuar mbështetje për të vepruar ndryshe - dhe tani kur e keni rastin, e bëni pikërisht të njëjtën. Ka mbetur vetëm edhe të premtohet që Zhegra dhe Zhuri do të bëhen komuna", ka shkruar ai.

IKD-ja: Të ndalen deklaratat politike që cenojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor

Prishtinë, 27 tetor - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka bërë thirrje që të ndalen akuzat në mes të Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Përmes një reagimi për media, IKD-ja ka vlerësuar se kjo qasje po e cenon pavarësinë e sistemit të drejtësisë në vend dhe po i rrezikon reformat e nevojshme për sistemin e drejtësisë. "Vendimi i fundit i KPK për të ngrirë bashkëpunimin institucional me Ministrinë e Drejtësisë, sikurse edhe deklaratat politike të Ministrisë së Drejtësisë ndaj sistemit prokurorial, cenojnë dhe dëmtojnë pavarësinë e sistemit prokurorial të garantuar me Kushtetutë dhe ligj, paraqesin pengesë për ta promovuar sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe zbatimin e reformave të filluara", është thënë në reagimin e IKD-së.

Ky institut ka bërë me dije se Kosova po kalon në fazë kritike që lidhet me tri procese të rëndësishme për përmirësimin dhe ngritjen e sistemit të

drejtësisë në vend, si procesi i vettingut, zbatimi i Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe pakoja e ligjeve të sistemit prokurorial në Kosovë. "Vettingu, IKD-ja vlerëson dhe mbetet pranë nismës së saj për ta përfshirë sistemin e drejtësisë në procesin e Vettingut, si proces pa alternativë. Si i tillë, ky proces kërkon dialog konstruktiv dhe të bazuar në fakte dhe mirëbesim në mes të partisë në pushtet në radhë të parë me partnerët ndërkombëtarë, pasuar me dialog konstruktiv dhe përmbajtjesor me aktorët e sistemit të drejtësisë, partitë politike opozitare dhe komunitetet joshumicë në Kosovë", është thënë në reagim. Sa i përket Strategjisë për Sundimin e Ligjit, IKD-ja ka vlerësuar se miratimi i kësaj strategjie mbetet një ndër sukseset më të mëdha në fushën e sundimit të ligjit nga viti 1999. "Miratimi i kësaj strategjie është përcjellë së paku në katër vjetët e fundit me një dialog dhe bashkëpunim konstruktiv mes partive në pushtet me aktorët e



sistemit të drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë, përfshirë ndihmën profesionale dhe financiare të partnerëve ndërkombëtarë. Strategjia parasheh që zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të saj realizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sistemit të drejtësisë", ka vlerësuar IKD-ja, duke përmendur pakon e ligjeve të sistemit prokurorial. "Pjesë e zbatimit të Strategjisë është plotësim-ndryshimi i

ligjeve të sistemit prokurorial, ku hyjnë ligjet për KPK, Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Përmes këtyre ligjeve dhe në bazë të objektivave të përcaktuara me Strategji synohen të rriten dhe përmirësohen llogaridhënia, integriteti, profesionalizmi, administrimi dhe menaxhimi efikas i sistemit prokurorial në Kosovë", ka vlerësuar institut. Të gjitha këto procese, sipas IKD-së, duhet të zhvillohen përmes

bashkëpunimit dhe mirëbesimit të ndërsjellë në mes të institucioneve qeveritare, aktorëve të sistemit prokurorial, partnerëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe publikut. "Fatkeqësisht, retorika e përdorur ditët e fundit në mes të aktorëve të caktuar të MD-së dhe sistemit prokurorial është duke penguar zhvillimin e këtyre proceseve. IKD në vazhdimësi ka potencuar se sistemi i drejtësisë ka probleme serioze, të konfirmuara edhe përmes raporteve ndërkombëtare, të cilat kërkojnë intervenime të shpejta, por përmes një procesi gjithëpërfshirës të bazuar në mirëbesim dhe bashkëpunim institucional. IKD-ja në pajtim me obligimet që dalin nga Kushtetuta e Kosovës, por edhe standardet ndërkombëtare, dënon çdo deklaratë politike që cenon pavarësinë dhe integritetin e sistemit prokurorial dhe që paraqet pengesë për të vazhduar me reformat e sistemit të drejtësisë", është thënë në reagimin e IKD-së.

Formohet komisioni qeveritar për rrugën Prizren - Tetovë



Prishtinë, 27 tetor - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për formimin e komisionit qeveritar për studimin e fizibilitetit për rrugën Prizren - Tetovë. Me këtë rast, ministri i Mjedisit dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, pas mbledhjes së qeverisë, ka dhënë informacione për rrugën

Prizren - Tetovë. Me këtë rast, Aliu ka thënë se ky projekt është shumë i rëndësishëm për shkak se lidh Prizrenin me Tetovën e, po ashtu, lidhet edhe me rrugë që çojnë në Shkup, Durrës, Prishtinë dhe Tiranë. "Ky është hap konkret pas marrëveshjes e cila u nënshkrua në Shkup në mes të dy kryeministrave dhe e

cila ka të bëjë me realizimin e një projekti të rëndësishëm që përpos që lidh dy qytetet, Prizrenin dhe Tetovën, lidh edhe dy korridore shumë të rëndësishme që është korridori 8 që nga Shkupi arrin në Durrës përmes Librazhdit dhe korridorit, rrugës së 'Kombit', nga Prishtina në Tiranë. Këto dy

korridore do të mund të lidhen në mes vete përmes rrugës Prizren - Tetovë", ka deklaruar ai. Aliu ka thënë se studimet e parafizibilitetit janë kryer dhe me vendimin e qeverisë do të fillojë puna konkrete teknike. "Studimet parafizibilitetit tashmë janë bërë nga ana e

Drejtorisë së Rrugëve në Republikën e Maqedonisë dhe me nënshkrimin e marrëveshjes mes dy qeverive në Shkup dhe me vendimin e sotëm do të fillojë puna konkrete teknike drejt përfundimit të këtij studimi dhe fillimit të projektit të menjëhershëm për realizimin e kësaj rruge", ka thënë Aliu.

Ndërron jetë regjisorja Burbuqe Berisha

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Regjisorja e njohur shqiptare, Burbuqe Berisha, ka ndërruar jetë të mërkurën në Prishtinë. Lajmin e kanë konfirmuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). “Me pikëllim ju njoftojmë se sot në mesditë, në Ministrinë e Kulturës, papritmas ka ndërruar jetë regjisorja e filmit dhe e teatrit Burbuqe Berisha. Jemi thellësisht të prekur nga kjo ngjarje dhe i shprehim ngushëllime familjes, miqve dhe gjithë komunitetit artistik”, ka njoftuar MKRS-ja.

Burbuqe Berisha ishte regjisore e një numri të konsiderueshëm të filmave të shkurtër, të gjatë, dokumentarë, serive televizive, shfaqjeve teatrore dhe fituese e disa shpërblimeve në festivale të filmit dhe teatrit me karakter vendor dhe ndërkombëtar. Berisha në vitin 2019 mori çmimin kombëtar për kinematografi.

Ajo ka punuar menaxhere në “Kino ABC” në Prishtinë, si producente në “Kosova Film”, po ashtu ishte drejtore e përgjithshme e Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe anëtare e Këshillit Drejtues të QKK-së si dhe e Ansambllit “Shota”.

Së fundi ishte pjesë e përgatitjes së regjisë për koncertin inaugurues të Operës së Kosovës. Krahas një karriere të suksesshme në regji dhe film, Burbuqe Berisha ka ushtruar edhe profesionin e ligjërueses në Kolegjin “AAB”.



Fillon shpërndarja e 140 mijë vaksinave kundër gripit sezonal

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka bërë me dije se të mërkurën ka filluar shpërndarja e 140 mijë vaksinave kundër gripit sezonal. Kjo ministri ka treguar se qytetarët mbi 65 vjeç, personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe lehonat, personeli shëndetësor dhe fëmijët me indikacione shëndetësore janë

kategori me prioritet për ta marrë vaksinën kundër gripit. “Nga sot ka filluar shpërndarja e 140 mijë vaksinave kundër gripit sezonal. Kategoritë me prioritet për vaksinim kundër gripit sezonal janë: qytetarët mbi 65 vjeç, personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe lehonat, personeli shëndetësor dhe fëmijët me indikacione

shëndetësore. Koha për vaksinim është tani sepse vakcina ju mbron juve dhe njerëzit përreth nga gripi sezonal si dhe e ul ngarkesën e sistemit shëndetësor gjatë pandemisë Covid-19. Secila komunë do t’i informojë qytetarët e saj për oraret dhe qendrën e vaksinimit kundër gripit sezonal”, ka njoftuar MSh-ja.

Një i vdekur dhe 22 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë ka vdekur një person nga Covidi dhe janë paraqitur 22 raste të reja me koronavirus. Sipas kësaj ministrie, gjatë kësaj

periudhe kohore janë dhënë 6 239 doza të vaksinës kundër Covid-19. “Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 549 215 doza të vaksinës. Deri më sot 712 793 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 2 095 testime, 22 qytetarë

kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Sot janë shënuar 20 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 276. Në total numri i rasteve aktive është 428”, ka njoftuar MSh-ja.



Kushtetuesja pezullon vendimin e Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të KPMSHCK-së

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për caktimin e masës së përkohshme ndaj vendimit të Kuvendit të Kosovës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK). Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese ka pezulluar vendimin e Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të këtij këshilli. "Megjithatë, dhe duke marrë parasysh që kërkesa para gjykatës ngre një sërë çështjesh lidhur me pavarësinë dhe funksionimin e këshillit, si një institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutë dhe i cili siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, vlerësoi se ishte e nevojshme vendosja e masës së pakohshme sipas detyrës zyrtare, bazuar në nenin 27 (masat e përkohshme) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56 (Kërkesa për Masë të

Përkohshme) të Rregullores së Punës. Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në vendimin e publikuar, duke theksuar se vendosja e masës së përkohshme nuk paragjykon pranueshmërinë ose meritat e rastit, gjykata vendosi masën e përkohshme deri më 15 dhjetor 2021, duke pezulluar menjëherë vendimin e kontestuar, dhe duke përcaktuar që Kuvendi duhet të përmbahet nga çdo veprim lidhur me çështjen e zgjedhjes së anëtarëve të rinj deri në vendimin përfundimtar të gjykatës", ka njoftuar Gjykata Kushtetuese.

Kuvendi i Kosovës më 30 qershor të këtij viti ka shkarkuar nga pozita e anëtarit të KPMSHCK-së, Jeton Kocën, Ardita Haxhinikajn, Malsore Gashi-Bjaraktarin, Arben Mehmetin dhe Eshref Shabanin. Jeton Koca gjatë procesit të vlerësimit ka qenë më i vlerësuar nga britanikët të cilët kishin marrë pjesë në intervistim.



Valdete Daka nis betejën ligjore kundër vendimit të presidentes Osmani

PRISHTINË, 27 TETOR - Ish-kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, i është drejtuar Avokatit të Popullit me kërkesë për ta shqyrtuar shkarkimin e saj nga presidentja Vjosa Osmani. Pas dorëzimit të kërkesës në këtë institucion, Daka ka thënë se beson se kjo çështje do të procedohet në Gjykatën Kushtetuese. "Ashtu siç e kam paralajmëruar, e kam dorëzuar ankesën time. Shpresoj që në kuadër të kompetencave do ta shfrytëzoj të drejtën e tij. Avokati i Popullit është institucion i pavarur dhe në momentin kur i kërkohet që ta dërgojë këtë kërkesë. Unë konsideroj që pas këtyre raporteve që kanë dalë nga BE-ja edhe Avokati i Popullit ka bazë ligjore që kërkesën time ta shqyrtoj në Gjykatën Kushtetuese", ka deklaruar Daka. Ajo ka deklaruar se deri tani ka prituri që kjo çështje të ngrehet



nga deputetët e Kuvendit. "Kam prituri, pasi kam konsideruar që deputetët do t'i mbledhin

nënshkrimet dhe do ta kërkojnë vlerësimin e kushtueshmërisë, por deputetët nuk kanë pasur

shumë gatishmëri. Por edhe për shkak të zgjedhjeve nuk kam dashur që askush të mos e

përdorë për çështje politike. Nuk jam ankuar në gjykata të tjera pasi konsideroj që nuk ka mundësi që të vlerësohet vendimi i presidentit, kjo mund të bëhet nga Gjykata Kushtetuese", ka deklaruar Daka.

Më 14 qershor të këtij viti Valdete Daka ishte shkarkuar nga presidentja Vjosa Osmani. Në arsyetimin e vendimit për shkarkim ishte thënë se kryesuesja e KQZ-së duhet të jetë e pavarur. "Znj. Valdete Daka i ndërpritet mandati si kryesuese e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit", ishte thënë në vendim.

Vendimi për shkarkimin e Dakës ishte kundërshtuar nga partitë opozitare dhe shoqëria civile. Shkrimi i Dakës është përmendur edhe në raportin e vëzhguesve të BE-së të cilët kanë monitoruar zgjedhjet lokale të 17 tetorit.

Osmani takohet me ushtarët e FSK-së që shërbyen në Kuvajt

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka prituri në takim kontingjentin e ushtarëve të FSK-së që kanë shërbyer në misionin e parë paqeruajtës jashtë vendit në Kuvajt. Me këtë rast, presidentja Osmani i ka

përgëzuar ushtarët për përmbylljen e suksesshme të misionit të parë të FSK-së jashtë vendit krahas me ushtarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Presidentja Osmani ka vlerësuar se përvoja e fituar nga ushtria e Kosovës në këtë

mision të çmueshëm vërteton kapacitetet e ndërveprimit me ushtritë e vendeve aleate. Kjo përvojë do t'i mundësojë FSK-së pjesëmarrje në misione të tjera jashtë vendit në bashkëpunim me shtetet aleate.



FLET PËR "EPOKËN E RE", ATDHE HYKOLLI

Qeveria me urgjencë të vendosë për rritjen e pagës minimale

Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, ka thënë se gjendja e punëtorëve, sidomos e atyre në sektorin privat në Kosovë, nuk është e mirë. Në këtë kontekst, ai ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që me urgjencë të vendosë për rritjen e pagës minimale. "Kërkojmë që paga minimale të rritet sa ma parë që të jetë e mundshme në mënyrë që ta reflektojë rritjen e kostos së jetesës dhe rritjen e çmimeve", ka thënë ai në këtë intervistë për "Epokën e re". Po ashtu, Hykolli ka kërkuar miratimin e Ligjit për Pagat dhe të atij për Sigurimet Shëndetësore

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 TETOR - Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykolli, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që me urgjencë të vendosë për rritjen e pagës minimale. "Qeveria duhet që me urgjencë të vendosë për rritjen e pagës minimale si parakusht për tejkalim të krizës sociale që ka shkaktuar rritja e vazhdueshme e çmimeve", ka thënë Hykolli.

Në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re", ai ka numëruar një varg ligjesh që, sipas tij, duhet të jenë prioritet i Qeverisë së Kosovës sa i përket respektimit të të drejtave të punëtorëve. "Urgjent është ndryshimi i pagës minimale, pastaj Ligji i Pagave, zbatimi i Ligjit të Punës dhe Ligjit për Sigurime Shëndetësore etj.", ka deklaruar ai. Po ashtu, Hykolli ka kërkuar edhe shtimin e numrit të inspektorëve. "Natyrisht që nuk ka numër të mjaftueshëm të inspektorëve. Qeveria duhet të bëjë më tepër jo vetëm në këtë drejtim, por duhet edhe ta ndryshojë qasjen ndaj punëtorëve duke ua kthyer dinjitetin me pagë dhe mbështetje", ka thënë Hykolli

"Epoka e re": Z. Hykolli, tani keni mandatin e parë në krye të BSPK-së. Çfarë hapash keni ndërmarrë që nga ardhja në

këtë pozitë?

Hykolli: Unë isha pjesë e BSPK-së edhe më herët, në pozitën e nënkryetarit, andaj tranzicioni ishte i lehtë sepse edhe më herët kam qenë në rrjedha. Ne e patëm një kongres të organizuar shkëlqyeshëm prej të cilët dolën organet e reja, përfshirë edhe kryetarin e ri. Tani jemi në fazën e konsolidimit të brendshëm të kryesisë dhe nënkryetarëve. Në të njëjtën kohë ne jemi angazhuar menjëherë për përkrahje të punëtorëve. Kemi iniciuar punën e Këshillit Ekonomik-Social dhe presim qeverinë të na bashkëngjitet në mënyrë që ta ndryshojmë pagën minimale. Gjithashtu, kemi kërkuar miratimin e marrëveshjes kolektive, Ligjit për Paga si dhe implementimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore.

"Epoka e re": Si e vlerësoni gjendjen e punëtorëve në sektorin privat në Kosovë, konkretisht respektimin e Ligjit të Punës?

Hykolli: Gjendja e punëtorëve në përgjithësi është jo e mirë, ndërsa në sektorin privat është më e vështirë meqë ka ngecje të respektimit të Ligjit të Punës. Megjithatë, nuk është vetëm ky një ndër problemet. Vështirësia më e madhe është mosndryshimi i deritashëm i pagës minimale, duke bërë që në sektorin privat pagesat të



jenë shumë të ulëta. Ne si BSPK kërkojmë që paga minimale të rritet sa ma parë që të jetë e mundshme, në mënyrë që të reflektojë rritjen e kostos së jetesës dhe rritjen e çmimeve.

"Epoka e re": Sa i përket numrit të inspektorëve, sa ka kapacitet Kosova për inspektim të kushteve të punës dhe çfarë numri të inspektorëve duhet të kemi në mënyrë që të përfillën të drejta e punëtorëve?

Hykolli: Natyrisht që nuk ka numër të mjaftueshëm të inspektorëve. Qeveria duhet të bëjë më tepër jo vetëm në këtë drejtim, por duhet edhe ta ndryshojë qasjen ndaj punëtorëve, duke ua kthyer dinjitetin me pagë dhe mbështetje.

"Epoka e re": Në cilat aspekte duhet të intervenohet me urgjencë sa iu përket kushteve

të punës?

Hykolli: Urgjent është ndryshimi i pagës minimale, pastaj Ligji i Pagave, zbatimi i Ligjit të Punës, Ligjit për Sigurime Shëndetësore etj.

"Epoka e re": Në Kosovë kemi rritje çmimesh, por jo edhe ngritje të pagave. Si duhet të veprohet në këtë drejtim?

Hykolli: Siç thashë edhe më parë, qeveria duhet që me urgjencë të vendosë për rritjen e pagës minimale si parakusht për tejkalimin e krizës sociale që ka shkaktuar rritja e vazhdueshme e çmimeve.

"Epoka e re": Z. Hykolli, shqetësuese prej kohësh shihet dhe mungesa e sigurimeve për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. A e keni adresuar këtë çështje?

Hykolli: Zbatimi i Ligjit për Sigurime Shëndetësore është shumë i rëndësishëm jo vetëm

për Policinë e Kosovës, por edhe për të gjithë të punësuarit e tjerë. Andaj ne kërkojmë nga qeveria që të fillojë zbatimi i këtij ligji që nga viti i ardhshëm.

"Epoka e re": Cili është bashkëpunimi i BSPK-së me vendet e rajonit, meqë me rastin e zgjedhjes suaj kemi parë edhe homologun tuaj nga Shqipëria?

Hykolli: Ne si BSPK kemi bashkëpunim të shkëlqyer me sindikatat rajonale, evropiane dhe botërore. Ky bashkëpunim shkon përtej takimeve formale siç ishte kongresi, duke synuar një bashkërendim aktivitetesh dhe veprimtarish në dobi të punëtorëve. Gjithashtu, të gjithë mund të përfitojmë nga shkëmbimi i ideve dhe përvoja më të mira. Ne do të vazhdojmë të kultivojmë këtë frymë bashkëpunimi me sindikatat e Shqipërisë, rajonit dhe më gjerë.



Miratohet Projektregullorja që tatimi në pronë të mos jetë kusht për regjistrimin e automjeteve

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën Projektregulloren e cila ua mundëson qytetarëve regjistrimin e automjeteve pa e paguar tatimin në pronë. Me këtë rast, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve,

Hekuran Murati, ka thënë se nëse shfuqizohet udhëzimi administrativ, do të mundësohet regjistrimi më i lehtë i automjeteve. Sipas tij, kësaj do të regjistrohen edhe më shumë automjete. Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe

konceptdokumentin për vlerësimin strategjik-mjedisor. Po ashtu, qeveria ka miratuar edhe vendimin për t'i propozuar Kuvendit të Kosovës kandidatët për bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.



A të çonin vërtet të gjitha rrugët në Romë?

Nga: Benjamin PLACKETT

Në kulmin e fuqisë së saj, Perandoria Romake zotëronte një rrjet rrugor që shtrihej nga Gjibraltari deri në kënetat e Mesopotamisë. Siç e thotë edhe vetë shprehja e vjetër popullore: “Të gjitha rrugët të çojnë në Romë”. Por a ishte vërtet kështu? Përgjigja nuk është aq e lehtë, sa të thuhet “po” ose “jo” pa asnjë mëdyshje. Ajo është paksa më e komplikuar se sa kaq. Në vitin 2015, tre studiues të “Moovel Lab”-it, një ekip ekspertësh urbanistë gjermanë, hodhën një rrjet uniform prej gati 500 mijë pikash në një hartë të Evropës. Këto pika nuk përfaqësonin qytetet e lashta apo moderne, por ishin thjesht vende të rastësishme nga të cilat mund të niste dikur një udhëtim drejt kryeqytetit perandorak. Më pas ekipi përdori një algoritëm për të llogaritur rrugën më të mirë për të shkuar në Romë, duke përdorur rrugët moderne nga secila prej atyre pikave fillestare. Rezultatet e tyre treguan një rrjet hipnotizues rrugësh që të çonin vërtet në Romë, dhe rrugës ato lidhnin edhe qytete të tjera të mëdha si Londra, Kostandinopoja (Stambolli i sotëm) dhe Parisi, të cilat ishin gjithashtu pjesë e perandorisë së

lashtë.

Lajmet mbi këtë lloj harte u bënë virale. Por, në fakt ai eksperiment nuk vërtetoi se të gjitha rrugët të çojnë në Romë. Nëse studiuesit do të kishin bërë të njëjtën gjë, por në vend të Romës do të llogaritnin se cilat ishin rrugët prej nga ku mund të mbërrisesh më shpejt në Berlin apo Moskë nga të njëjtat 500 mijë pika, harta do të tregonte një sërë rrugësh po aq të gjera që çonin në ato qytete. “Studimi ynë nuk i dha përgjigje pyetjes nëse të gjitha rrugët të çojnë vërtet në Romë. Ai ishte një eksplorim në masën 99për qind të asaj pyetjeje”, tha Philipp Schmitt, një nga ekspertët e grupit. Gjithsesi ai eksperiment na tregon ende diçka për qëndrueshmërinë e rrugëve romake.

Shumica e infrastrukturës rrugore në Evropë është ende e projektuar në mënyrë të tillë që të lidhë qytetet kryesore me kryeqytetin italian, duke qenë potencialisht një trashëgimi e perandorisë së dikurshme. Studiues të tjerë, kanë zbuluar gjithashtu se kjo gjë është e vërtetë.

Harta e krijuar nga “Moovel Lab” shqyrtoi mënyrën më të mirë për të mbërritur në Romë duke përdorur rrugët moderne. “Ne i kemi përdorur modelimet

kompjuterike për të parë rrugët më të mundshme apo më logjike që lidhin dy pika të caktuara, dhe pastaj e krahasojmë atë me njohuritë tona mbi rrugët romake, për të parë nëse ato janë të ngjashme”, thotë César Parcerro-Oubina, arkeolog i peizazheve në Institutin e Shkencave të Trashëgimisë në Madrid të Spanjës. “Rrugët e sotme janë shpesh të njëjta në shumicën e rasteve me ato të dikurshmet”.

Pra, shumë prej autostradave të Evropës me shumë korsi, janë pasardhëset e rrugëve romake. Gjithsesi kjo ka ndryshuar vitet e fundit, thekson Oubina. “Sot autostradat e reja shmangin vendet e populluara për të kursyer para në procesin e shpronësimeve. Kjo do të thotë që disa autostrada sot nuk ndjekin trajektoren e rrugëve të vjetra romake”, nënvizon ai.

Dhe, kjo na çon tek pyetja në fjalë: Cila ishte logjika e romakëve në ndërtimin e rrugëve? A të çonin vërtet të gjitha rrugët në Romë?

“Kjo varet nga rëndësia e rrugës. Logjika se si funksiononte një perandori e lashtë nuk është aq e ndryshme nga një vend modern. Romakët nuk ishin aq të ndryshëm nga ne; ata thjesht po përpiqeshin që të minimizonin rrugët për të kursyer kohë”,

shprehet Ubino.

Rrugët kryesore ishin vija të drejta sa herë që këtë e lejonte peizazhi gjeografik, dhe ato lidhnin qytete të rëndësishme me qytete të tjera të rëndësishme. Këto rrugë ishin të mundshme vetëm pasi një vend të ishte aneksuar siç duhet nga romakët dhe të ishte nënshtruar çdo kundërshtimi ushtarak, përndryshe do të kishte qenë e pasigurt për të udhëtuar në rrugë të tilla.

Në ditët e para pas pushtimit të një krahine, kur barbarët (jo-romakët) po i rezistonin ende pushtimit, romakët do të përdornin rrugët më të sigurta dhe që përshkonin më pak zonat me pyje të dendura apo male. Ndërkohë, kur në një krahinë të aneksuar mbizotëronte paqja, këto rrugë formuan një lidhje jetike për të shpejtuar tregtinë dhe për ta mbajtur ushtrinë në vijën e frontit të furnizuar mirë me trupa dhe furnizime ushqimore.

Në kulmin e saj, rrugët e Perandorisë Romake përshkuan kontinentet për të lidhur qytete dhe qyteza të rëndësishme me kryeqytetin e saj. “Rrugët kryesore lidhnin vende të rëndësishme, dhe kështu në një mënyrë a tjetër, të gjitha mbaronin ose fillonin në Romë. Por nuk është se duhet të kalonit

përmes Romës kur udhëtonit nga Londra në Paris, vetëm sepse këtë e lejonte rrjeti”, thekson Oubina.

Këto rrugë kryesore ishin krijuar për lëvizjen e karrocave me rrota dhe kafshëve. Pra, ishin shumë më të sofistikuar sesa shtigjet plot me baltë. Ato u ndërtuan me shtresa të ndryshme si dhe shkëmb, dhe më në fund me pllaka të mëdha guri në majë. Ato nuk ishin të sheshta, por në formë kubi për të lejuar kullimin e duhur. Pastaj vinin rrugët e tjera dytësore që nuk ishin të asfaltuara. Ato lidhnin më shumë qytete dhe qyteza, në vend se të ofronin ndonjë lloj rruge për në Romë. Atëherë, të gjitha rrugët romake të çonin në Romë? Jo tamam, por ato më të rëndësishme të çonin përfundimisht atje. Premisa e pyetjes mund të jetë gjithsesi e gabuar, sepse shumica e njerëzve që shkonin në Romë nuk ndiqnin rrugët tokësore.

Lidhja përmes detit ishte shumë më e dobishme, sepse ishte më e shpejtë dhe më e lirë. Për shembull nëse dëshironit të udhëtonit nga Iberia perëndimore në Romë, atëherë me siguri që do të hipnit në një anije dhe jo mbi një kalë apo karrocë”. përfundon Oubina. /Burimi: “Livescience” /Në shqip nga: Bota.al/



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Shabani: Gjilani do të rikthehet duarbosh nga Klina

Dukagjini e zhvillon ndeshjen e radhës ndaj Gjilanit në kuadër të javës së dymbëdhjetë në Superligë. Bujar Shabani shpreh optimizëm se Dukagjini mund të arrijë fitore në këtë ndeshje. “Kundërshtari i radhës ka një ekip cilësor me lojtarë shumë të mirë çka dëshmojnë edhe rezultatet e tyre në këtë sezon, por ne jemi duke u përgatitur dhe me pak fat besojmë se mund t’i marrim pikët e plota”, ka thënë Shabani



EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 TETOR - Skuadra e Dukagjinit nga Klina është rikthyer në këtë edicionin në Superligën e Kosovës në futboll me synime të mëdha, por në dhjetë xhirot e para kjo skuadër nuk ka arritur të marrë më të mirën, ani pse diferenca e pikëve me skuadrat e tjera nuk është e madhe. Pas humbjes nga Drita në fundjavën e kaluar, ndeshjen e radhës kjo skuadër e zhvillon me klubin tjetër nga qyteti i Gjilanit, Gjilanin e drejtuar nga Ismet Munishi. “Në këtë sezon nuk është se kemi marrë atë që e kemi merituar. Kemi bërë lojëra shumë të mira, por rezultatet pozitive na kanë munguar në disa ndeshje”, ka deklaruar Shabani.

Futbollisti Bujar Shabani, që është ndër lojtarët me përvojën me të madhe në futbollin e Kosovës, ka folur edhe për ndeshjen e radhës. Ai ka thënë të mërkurën për “Epokën e re” se Dukagjini e pret një ndeshje shumë e vështirë, por përgatitjet janë duke u bërë për të nxjerrë një rezultat të favorshëm. “Ndeshjen e radhës e zhvillojmë kundër Gjilanit që do të jetë mjaft e vështirë. Kundërshtari i radhës ka një ekip cilësor me lojtarë shumë të mirë çka dëshmojnë edhe rezultatet e tyre në këtë sezon, por ne jemi duke u përgatitur dhe me pak fat besojmë se mund t’i marrim pikët e plota. Mungesa e vetme për këtë ndeshje është ajo e Ilir Sylës për shkak të kartonit të kuq”, ka thënë Shabani. Dukagjini ndeshjen e parë të këtij sezoni si mysafir i Gjilanit e luajti 0-

0, derisa nga njëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar dy fitore, katër barazime dhe pesë humbje. Klubi nga Klina renditet në vendin e tetë me 10 pikë, aq sa kanë edhe dy skuadrat e tjera Ulpiana dhe Feronikeli.

Rezultatet e Dukagjinit

Ballkani - Dukagjini	2-2
Dukagjini - Drenica	1-2
Gjilani - Dukagjini	0-0
Feronikeli - Dukagjini	1-0
Dukagjini - Prishtina	1-2
Ulpiana - Dukagjini	0-0
Dukagjini - Drita	2-1
Llapi - Dukagjini	1-0
Dukagjini - Malisheva	2-0
Dukagjini - Ballkani	0-0
Drenica - Dukagjini	2-0
Dukagjini - Gjilani	?-?

SHKURT

Rahoveci transferon amerikanin e pestë

KB Rahoveci e ka kompletuar transferimin e Cavon Bakerit, i cili është amerikan i pestë në skuadër. Bakeri që luan në pozitën 1 dhe 2 së fundmi ishte pjesë e NCAA te skuadra Saint Peter's. “Cavon Bakeri është aktualisht amerikan i pestë i skuadrës sonë që do t’i mbrojë ngjyrat e klubit tonë. Bakeri është lojtar i pozitës 1/2, gjatësia e tij prej 185 cm e bën atë mjaft të shpejtë në lëvizjet depërtuese në trapez. Së fundmi Cavon Baker është paraqitur në NCAA te skuadra Saint Peter's”, thuhet në njoftimin e Rahovecit.

Llapi: Superkupa ‘Kosovë - Diasporë’ i bashkohet vitrinës së trofeve

Skuadra e Llapit e ka fituar Superkupën “Kosovë - Diasporë” pasi e ka mposhtur FC Kosova Dusseldorf me rezultat 2-0. Pas këtij trofeu Llapi ka publikuar një foto nga vitrinat e klubit duke shkruar se ajo u pasurua edhe me një kupë të çmuar. “Superkupa ‘Kosovë - Diasporë’ i bashkohet vitrinës së trofeve. KF Llapi kompletion vitrinën e trofeve të fituar brenda vitit kalendarik 2021. Ky vit ishte i jashtëzakonshëm për ekipin tonë duke marrë parasysh edhe vështirësitë që na përcollën, megjithatë arritëm që të sjellim tre trofe në Podujevë brenda pak muajve. Së pari, Kupën e Kosovës më 12 maj, më pas Superkupën e Kosovës më 17 gusht dhe Superkupën ‘Kosovë - Diasporë’ të fituar ndaj FC Kosova Dusseldorf. Këto suksese të arritura janë meritë e punës së palodhshme të kryesisë që mbështetën pa rezervë ata që pa dyshim janë meritore për këto trofe: shtabin teknik, stafin punues dhe lojtarët. Vazhdojmë!”, thuhet postimin e Llapit në faqen e vet zyrtare.

Tare bisedon me Starkoshën për çështjen e rinovimit

Tomas Strakosha po gjen shpëtim në Ligën e Evropës, e vetmja dritare për momentin ku gardiani kuqezi mund t’i shprehë aftësitë e tij. Portieri shqiptar është futur në një vit shumë përcaktues, është në vitin kur i skadon kontrata, për këtë arsye si Strakosha ashtu edhe Igli Tare janë vënë në lëvizje për të gjetur një zgjidhje ideale për të dyja palët. Sipas mediave italiane, mes palëve është diskutuar e ardhmja dhe kontrata që i skadon më 2022. Tare ka një ofertë konkrete për Strakoshën, një kontratë të re katërveçare dhe një pagë vjetore prej dy milionë eurosh. Dëshira e Lazios dhe e Tarës është ta vijojë bashkëpunim me portierin kuqezi, mbi të gjitha nuk dëshirojnë ta humbasin falas. Mbetet për t’u parë se çfarë do të vendosë Strakosha, i cili kërkon garanci, pasi nuk mund të qëndrojë një rezervë e Pepe Reinas.

Kosova përparon në ranglistën e EHF-së

PRISHTINË, 27 TETOR - Federata Evropiane e Hendbollit së fundmi ka publikuar ranglistën në bazë të së cilës përcaktohet numri i skuadrave pjesëmarrëse në edicionin 2022/2023 të garave evropiane. Për bazë janë marrë rezultatet e skuadrave në tri edicionet e kaluara, 2018/19, 2019/2020 dhe 2020/2021. Pra jo edhe edicioni aktual 2021/2022. Sa iu takon klubeve të hendbollistëve, Kosova ka

përparuar për një pozitë. Kosova tani renditet e 29-ta dhe ka lënë Holandën në vendin e 30. 4.33 janë pikët mesatare të Kosovës, ndërsa 4.20 të Holandës. Sipas ranglistës së publikuar nga EHF-ja, Kosova te hendbollistët lë 21 vende evropiane prapa. Kosova edhe edicionin e ardhshëm do t’i ketë katër skuadra të hendbollistëve në gara evropiane. Kampioni e ka të drejtën e paraqitjes në Ligën

Evropiane, që është niveli i dytë. Ndërsa tri skuadra të tjera e kanë të drejtën e paraqitjes në Kupën Evropiane, që është niveli i tretë. Te hendbollistët, Kosova ka mbetur në vendin e 27, të cilin e ndan me katër vende të tjera. 19 vende janë më poshtë në ranglistë. Edhe te hendbollistët Kosova do ta ketë të drejtën e garimit me katër skuadra, një në Ligën Evropiane e tri në Kupën Evropiane.



Rossi: Prej vitit 2015 s'kam qenë më vetja ime

URBINO, 27 TETOR - Piloti italian Valentino Rossi në fund të këtij sezoni do t'u thotë lamtumirë garave të MotoGP, pasi do të tërhiqet nga sporti. Ikona e garave të motoçiklizmit, në një intervistë për emisionin "Le Iene", ka rëfyer disa detaje nga jeta dhe karriera e tij. "Që

prej vitit 2015 nuk kam qenë më vetja ime, nuk kam qenë kompetitiv aq sa duhet. Unë kam ende dëshirë të garoj, por tashmë jam 42 vjeç, ndërsa pilotët e tjerë gati 20 vjet më të vegjël se unë", u shpreh Rossi, fitues i nëntë titujve kampionë në garat e motoçiklizmit. "Më vjen keq

që nuk e fitova titullin e dhjetë. Sidomos pas gabimit në garën e Valencias në vitin 2015. Ndiej keqardhje për atë sezon dhe që nga ai vit nuk kam qenë më vetja ime", ka shtuar Rossi, që konfirmon se do të vijojë karrierën në garat me makina, në kampionatin Endurance. Rossi

shpreh edhe një fakt interesant në lidhje me fansat e tij: "MotoGP, para meje, ishte sport i njohur, por jo aq i famshëm. Me mua, shumë njerëz iu afrua këtij sporti, nga fëmijët deri te 80-vjeçarët. Madje me gjyhet 80-vjeçarë kam shumë sukses, më duan shumë".



Cassano: Totti do të harrohet, vetëm Messi, Maradona dhe Cruyff janë të përjetshëm

ROME, 27 TETOR - Antonio Cassano mbron Luciano Spallettin dhe thotë se Francesco Totti do të harrohet pas 20 vjetëve pasi vetëm Leo Messi, Diego Maradona dhe Johan Cruyff janë të përjetshëm. Tifozët e Romës brohoritën emrin e Tottit dhe vazhduan ta fajësojnë Luciano Spallettin kur trajneri toskan u kthye në "Stadio Olimpico" të dielën për t'u përballur me Romën. Cassano, një ish-sulmues i Romës, mbrojti teknikun e Napolit dhe çuditërisht sulmoi ish-bashkëlojtarin e tij. "Ato goditje kundër Spallettit janë një turp. Ai bëri gjëra të mahnitshme në Romë dhe e donte klubin", ka deklaruar Cassano gjatë emisionit "Twitch Bobo TV", të drejtuar nga ish-sulmuesi i Italisë, Christian Vieri. "Për çfarë? Sepse e bëri Tottin të



pensionohej? Çmendem kur i dëgjoj këto gjëra. A po më thoni që Totti doli në pension sepse nuk luajti nën Spallettin? Kam luajtur në Romë, kështu që e di për çfarë po flas. Për mua është një skandal dhe më vjen keq ta them këtë sepse kam kaluar shumë mirë në Romë. Spalletti duhej të bënte zgjedhjet e tij dhe kur u kthye, u kualifikua në Ligën e

Kampionëve. Tifozët duhet të mendojnë për të mirën e Romës, Spalletti nuk meritonte kritika, por vetëm lëvdata. Nuk e meritonte", ka deklaruar ish-sulmuesi italian. "Totti do të harrohet pas 20 vjetësh, vetëm Messi, Maradona dhe Cruyff janë të përjetshëm. De Rossi ishte 'Capitan Futuro', por ai është harruar, nuk kam parë kurrë dikë që e do Romën aq shumë sa ai. Totti e do Romën, De Rossin 100 herë më shumë", ka shtuar Cassano, i cili kaloi katër vjet e gjysmë në kryeqytet, duke shënuar 52 gola në 161 paraqitje. Më pas ai u transferua në Real Madrid, ku qëndroi vetëm për një vit e gjysmë përpara se të kthehej në Serinë A, duke iu bashkuar Sampdorias. Ai, gjithashtu, luajti me Interin, Milanin dhe Parmën gjatë karrierës së tij si lojtar para se të pensionohej në vitin 2017.

Lakersat mposhtin spursat, Dallasi fiton derbin kundër Houstonit

TEKSAS, 27 TETOR - Los Angeles Lakersi regjistroi fitoren e dytë radhazi në NBA në transfertën ndaj San Antonio Spursit. Në "AT&T Center" në Texas kalifornianët fituan me rezultatin 125-121 pas kohës shtesë, udhëhequr nga dyshja Anthony Davis-Russell Westbrook. Ish-lojtari i Pelicans ishte më i miri mbi parket për lakersat me 35 pikë, 17 rebounde dhe 4 asistime, ndërkohë që Westbrook u transferuar gjatë kësaj vere te skuadra e Frank Vogel pak nga pak po gjen formën e tij më të mirë, teksa spikati me 33 pikë, 10 rebounde dhe 8 asistime. Suksesi e dytë radhazi e gjeti edhe Dallas Mavericksi që fitoi derbin teksan ndaj Houston Rocketsit me shifrat 116-106 për meritë edhe të Luka Donçiqit. Slloveni u shfaq në lartësinë e duhur duke kontribuar me 26 pikë, 14



rebounde dhe 7 asistime në një ndeshje të cilën Dallasi e zgjidhi në favor të saj vetëm në pjesën e dytë pasi në fraksionin e parë të lojës, Houstoni ishte më mirë. Për Rocketsit kjo ishte disfata e tretë në katër takime gjatë këtij sezoni që, ashtu si i kaluari, parashikohet i vështirë dhe më shumë luhatje. Në mbrëmjen e NBA-s buzëqeshi edhe Utah

Jazzi që kaloi me shifrat 122-110 Denver Nuggetsit në një sfidë që deri në periudën e katërt ishte në baraspeshë totale. Dy basketbollistët që spikatën më shumë në suksesin e skuadrës nga Salt Lake City ishin francezi Rudy Gobert me 23 pikë dhe 16 rebounde dhe Donovan Mitchell me 22 pikë. Vijon momenti i shkëlqyer për Jazz që i ka fituar të tria ndeshjet e këtij sezoni, ndërkohë që Nuggetsit pësoi humbjen e dytë rresht teksa nuk i mjaftuan as 24 pikët e Nikola Jokiçit. Nuk di më të ndalet Golden State Warriorsi që mori fitoren e 9-të rresht mes sfidave të pre-season dhe sezonit të rregullt, teksa arriti të triumfojë me shifrat 106-98 në transfertën ndaj Oklahoma City Thunderit. Stephen Curry me 23 pikë, 6 rebounde dhe 4 asistime ishte më i miri mbi parket për skuadrën nga San Francisco.

SHKURT

Leclerc: Ferrari ka ndryshuar pamje, ky është objektivi ynë real

Pas vendit të katërt të arritur në garën e zhvilluar në Austin, piloti mongask i Ferrarit, Charles Leclerc, mendon se vendi i tretë në renditjen e përgjithshme për konstruktorë është i arritshëm për "kokëkuqen". "Nga kjo garë në Amerikë nuk prisnim që të paraqiteshim kaq mirë. Ndërkohë që doli një nga garat tona më të mirë të këtij sezoni", ka thënë Leclerc. "Ritmi në atë garë ishte i mirë, çka tregon se ndryshimet e aplikuara janë efikase dhe dhanë rezultat. Të gjithë kanë bërë një punë të mirë, duke na ofruar një makinë kompetitive. Rikuperuam 4 pikë ndaj McLaren dhe mendoj se në garat e radhës mund të fitojmë sërish terren. Kemi ende disa modifikime për të aplikuar në vijim, që do të na ndihmojnë më shumë", ka deklaruar Leclerc.

Kloppi në 'radar' të Barcelonës

Trajneri Ronald Koeman duket se i ka ditët e numëruara në skuadrën e Barcelonës. Mediat në Spanjë raportojnë se dëshira e drejtuesve katalanas është që në krye të skuadrës të vendoset një trajner me emër të madh, si Jurgen Klopp. Pavarësisht prej kontratës që i skadon në vitin 2024 dhe ndjenjës së madhe mes tij dhe popullit të kuq, e ardhmja e tij do të varet shumë se si përfundon sezoni aktual. Disa pakënaqësi në vitin e kaluar mund të kishin ndryshuar mendimet e tij për të qëndruar në Angli, por ky fillimsezon mes Ligës së Kampionëve dhe Premierë Ligës duket se ka sjellë paqen mes palëve. Në çdo rast, shumë do të varet nga rezultatet që do të arrijë Liverpooli por, mbi të gjitha, nga ajo që Barcelona do t'i ofrojë verën e ardhshme. Blaugranat janë në kërkim të një trajneri të aftë për t'u lidhur me grupin dhe për ta bërë atë të performojë më mirë.

Hernandez i shpëtoi burgut

Mbrojtësi i Bayern Munchenit, Lucas Hernandez, i shpëton burgimit. Gjykata e Madridit ka pranuar apelin e futbollistit të Bayernit, i cili ishte dënues me gjashtë muaj burg për shkak se nuk kishte respektuar urdhrin e mbrojtjes së vendosur pas një episodi të dhunës në familje. Mbrojtësi francez është gjobitur me 96 000 euro. Urdhri i mbrojtjes u lëshua në vitin 2017 për vetë lojtarin francez dhe të dashurën e tij, Amelia Ossa Llorente, pas një debati të dhunshëm që ata patën. Vajza u dërgua në spital me plagë të lehta, ndërsa Hernandezi u akuzua për dhunë në familje, ndonëse askush prej tyre nuk kishte ngritur akuzë. Por më pas ata u rikthyen sërish bashkë në Spanjë pasi u martuan.

Xavi vendos tjetër rekord tek Al-Saddin

Xavi Hernandezi e regjistroi edhe një fitore së bashku me Al-Sadd 3-1 ndaj Umm Salal. Triumfi i tyre i fundit i lejoi ata që të shënojnë një rekord të madh, pasi janë 34 ndeshje pa humbje në lihu nën udhëheqjen e ish-mesfushorit të katalunasve. Kjo fitore ishte, po ashtu, e veçantë edhe për Santi Cazorlan që arriti të futej në listën e realizatorëve për Al-Sadd. Ai qëndroi për pesë minuta në fushë, duke u zëvendësuar më pas, por që ende ka klasë të lartë. Xavi në anën tjetër ka fituar tashmë shtatë tituj me Al-Sadd, gjersa është shumë afër të shpallet kampion dimëror. Në total, spanjollit ka drejtuar skuadrën nga Katari në 93 ndeshje, ka fituar 63, ka barazuar dhe ka humbur 16 sosh.

Kohfeltdi zëvendëson Van Bommel te Wolfsburgu

Wolfsburgu gjen pasuesin e Mark Van Bommel, ish-mesfushor holandez i cili u shkarkua pak ditë më parë për shkak të rezultateve të dobëta. Drejtuesit e ujqërve

kanë zgjedhur 39-vjeçarin Florian Kohfeltdi i cili nga viti 2017 deri në 2021-n, deri në fund të sezonit të kaluar, drejtoi skuadrën e Werder Bremenit me të cilën

gjatë kësaj periudhe mori vetëm 50 fitore në 143 ndeshje dhe në edicionin e shkuar nuk arriti ta evitonte rrëzimin e bardhëjeshilëve në Bundesligën

e 2-të. Kohfeltdi ka firmosur deri në vitin 2023 me Wolfsburgun duke marrë postin e Mark Van Bommelit me holandezin që, edhe pse e nisi në mënyrë të

shkëlqyer këtë sezon, u pushua nga puna pas humbjes ndaj Freiburgut duke u bërë trajneri i parë që largohet nga detyra në këtë sezon të Bundesligas.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a



Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë:27/10/2021 me nr ref: 01/0847, Policia e Kosovës shpall:

KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit.

Vendi i punës: Policia e Kosovës

A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kritere:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

B. Testet:

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

C. Forma e aplikimit:

Aplikimi në konkursin për zyrtarë policorë është online përmes ueb faqes zyrtare të PK-së: www.kosovopolic.com / Shpallje/Mundësi punësimi.

D. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës;
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumenti nga pika c dhe d të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

E. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

F. Zbatimi i vendimit të datës 27/10/2021 me nr ref: 01/0847 për zbatimin e masave të veçanta të përkohshme afirmative

Në këtë konkurs Policia e Kosovës do të ndërmer masa të veçanta të përkohshme afirmative me qëllim të garantimit të të drejtave të barabarta gjinore, promovimit të barazisë gjinore dhe me qëllim të rritjes së përfaqësimit të zyrtarëve policorë gra në Policinë e Kosovës.

Masat e veçanta të përkohshme afirmative që do të ndërmer Policia e Kosovës do të zbatohen në procedurën e rekrutimit dhe punësimit në Policinë e Kosovës, në mënyrë që gjatë procesit të rekrutimit të zyrtarëve policorë nga të gjithë ata kandidatët që do të plotësojnë kushtet dhe kalojnë pragun e kalueshmërisë 70% përparësi do të këtë gjinia femërore.

Aplikimi për zyrtar policor bëhet online. Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë përmes ueb faqes zyrtare të Policisë së Kosovës: www.kosovopolic.com nga data **28.10.2021** deri me datën **16.11.2021**.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1554 apo 1722 si dhe në 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes së aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimeve do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/Uprava za Ljudske Izvore PK-a

Na osnovu Zakona o Policiji, Poglavlje V, člana 44, Zakona o Radnom Odnosu Br. 03/L-212, Poglavlje II, član 8, Zakon o Ravnopravnosti Pola br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakon o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 8 i 9, tačka 1 i 2 i Odluke Generalnog Direktora:27/10/2021 pod br. ref: 01/0847, Policia Kosova objavljuje:

KONKURS

Za prijem policijskih službenika prema predviđenim uslovima konkurisanja.

Radno mesto: Policia Kosova

A. Kandidati koji apliciraju za policijskog službenika u Policiji Kosova treba da ispunjavaju sledeće uslove:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je uzrasta od 18-30 godine;
- Da ima završenu srednju školu;
- Da je u dobrom fizičkom, mentalnom i emocionalnom stanju;
- Da nije kažnjavan za neko krivično delo;
- Da nema na vidno mesto tetovaže (lice, vrat, ruke)
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti;

B. Testovi:

- Pismeno testiranje;
- Testiranje fizičkih sposobnosti;
- Intervjuisanje;
- Psihološko testiranje;
- Lekarska kontrola;
- Provera prošlosti;

C. Način apliciranja:

Apliciranje na konkurs za policijske službenike je online putem službene veb stranice PK-a: www.kosovopolic.com / Oglas/Mogućnosti za zapošljavanje.

D. Aplikaciji priložiti potrebnu dokumentaciju:

- Kopja diplome za srednje visoko obrazovanje, dok za kandidate koji su završili školovanje van zemlje kopija nostrifikovane diplome;
- Dokaze za ostale kvalifikacije;
- Izvod rođenih / ekstrakt rođenih;
- Potvrda iz suda da nije kažnjavan i nije pod istragom;
- kopija lične karte ili pasoša.
- Jedna fotografija veličine (5 x 5);
- Dokumentacija iz tačke c) i d) treba da su važeće i da su izdate nakon datuma objavljivanja konkursa.

E. Opšti zadaci i ovlašćenja Policije

- Da zaštiti život, imovinu i da pruži zaštitu za sve građane;
- Da zaštiti osnovna ljudska prava za sve građane;
- Da sprečava rizik nad građanima i da održava javni red i mir;
- Da sprečava i otkrije krivična dela i njihove počinioce;
- Da istražuje krivična dela i njihove počinioce;
- Da nadgleda i kontroliše bezbednost u saobraćaju;
- Da menadžira i kontroliše državnu granicu;
- Da pruža pomoć tokom prirodnih nezgoda i u drugim emergentnim situacijama;
- Da obavlja druge poslove predviđene Zakonom o Policiji.

F. Primenjivanje odluke od 27.10.2021 pod br ref: 01/0847 za sprovođenje posebnih privremenih afirmativnih mera

Na ovom konkursu Policia Kosova preduzeće posebne privremene afirmativne mere u cilju garantovanja jednakih rodniha prava, promovisanje rodne ravnopravnosti i sa ciljem povećanja zastupljenosti policijskih službenica žena u Policiji Kosova.

Posebne mere koje će preduzeti Policia Kosova sprovođiće se u proceduri regrutacije i zapošljavanja u Policiji Kosova, na načinu da tokom procesa regrutacije policijskih službenika od svih tih kandidata koji će ispuniti uslove i prelaze prag polaganja 70% imaće prednost ženski rod.

Apliciranje za policijske službenike vrši se online. Zainteresovani kandidati mogu aplicirati putem službene veb stranice Policije Kosova: www.kosovopolic.com od **28.10.2021** do **16.11.2021**.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na brojeve telefona: 038-5080 lokal: 1554 ili 1722, kao i na tel: 038/245-184, od 09:00-15:00h.

Uspešni izabrani kandidati biće pozvani da učestvuju na gore navedenim testiranjima. Informisanje kandidata u vezi svake faze testiranja objaviće se na službenoj veb stranici Policije Kosova, na adresi: www.kosovopolic.com i na oglasnoj tabli po Regionalnim Direkcijama i odgovarajućim Policijskim Stanicama.

“Policia Kosova služi celom narodu Kosova. Ova služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i očekuje aplikacije od osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu”.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	INDIVIDUAL CONSULTANT FOR THE THRESHOLD PROGRAM CLOSURE
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2021/024.1
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Services
Employer	Millennium Foundation Kosovo
Publication Date	27 October 2021
Submission Deadline	04 November 2021; 16:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for INDIVIDUAL CONSULTANT FOR THE THRESHOLD PROGRAM CLOSURE

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website (www.mcc.gov/ppg). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/individual-consultant-for-the-threshold-program-closure-ic-mfk-2021-024-1>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **04 November 2021; 16:00 pm (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address referred to above is:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	www.millenniumkosovo.org



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

NOTICE OF A CANCELLATION

Date: 27.10.2021

Procurement activity name: **INDIVIDUAL CONSULTANT FOR THE THRESHOLD PROGRAM CLOSURE**

Procurement activity no.: IC/ MFK/2021/024

Procurement Method: Individual Consultant

Millennium Foundation of Kosovo hereby informs that the Procurement activity referenced above canceled, due to none of the candidates meets the requested criteria.

A new contract notice will be published.

For any information, please contact the Procurement Team at below address:

Millennium Foundation of Kosovo

Address: Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana Building, 9th floor)

Postal Code:10000 Prishtina, Republic of Kosovo.

Email: procurement@millenniumkosovo.org

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Alfa Company ", Sh.p.k. Klinikë e Poshtme. Skenderaj, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Stacionin e karburanteve në Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.11.2021 në ora 10:00 do të organizohet **Debati Publik** në Restorantin e kompanisë " HIB " në Obiliq , që gjendet në anën e djathtë të Autostradës Prishtinë-Mitrovicë në kilometrin e tretë nga rreth rrotullimi i Prishtinës në drejtim të Mitrovicës. **Debati publik organizohet nga Kompania " Alfa Company ", Sh.p.k. Klinikë e Poshtme, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.**

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Stacionin e karburanteve në Obiliq

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Alfa Company ", Sh.p.k. Klinikë e Poshtme. Skenderaj për Stacionin e karburanteve në Obiliq

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "EKSmart" SH.P.K. me pronar Kujtim Robelli, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811390541, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "EKSmart" D.O.O. Kujtim Robelli, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues: 811390541 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "EKSmart" L.L.C. Kujtim Robelli, has come to the decision to quit its business: nr. Unik Identifikues: 811390541 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ ALEKS Kola shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Emin Duraku" Gjakovë nga kl. I-VIII.

▶ DENI Musa Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

▶ Mirlindë Islam Mazreku shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Fakultetit Juridik në U.P. Prishtinë.

▶ "O&D" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330322925.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

